# Prof. Asoc. Dr. Majlinda Keta



Majlinda Keta, është lektore pranë Departamentit të Filozofisë në Universitetin e Tiranës që nga viti 2008. Ajo është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës për “Punonjëse e shkencave politike” (1985) dhe “Juriste”, (2004). Ka kryer Shkollën Pasuniversitare për Studime Europiane, pranë Universitetit të Tiranës, (2008) dhe më pas ka mbrojtur doktoraturën në filozofi (2015) për rolin e filozofisë për edukimin për zhvillim të qendrueshëm. Në prill 2022 ka fituar titullin akademik “Profesor i Asociuar”.

Ka kryer shumë kualifikime jashtë vendit për të drejtat e njeriut, demokracinë, qytetarinë, lidershipin, politika arsimore dhe qeverisje. Ka botime për këto fusha, kryesisht për përfshirjen e tyre në kurrikulën shkollore dhe kualifikimin e mësuesve. Ajo ka botimet e saj në tekste shkollore, manuale dhe vëllime eseike. Ajo zotëron kompetencën e ToT në fushën e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe inisiativave antikorrupsion. Ka përmbushur disa detyra dhe angazhime në poste drejtuese në arsim dhe në Shoqëri Civile. Është aktive në publicistikë e media televizive për demokracinë, arsimin, mirëqeverisjen, kulturën politike, gruan, fëmijët dhe filozofinë. Prej 2009 është anëtare e Rrjetit të Grave Filozofe pranë UNESCO.